

**Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:
Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 858, datë
29.12.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””**

1. Titulli i projektaktit

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektakti është hartuar nga një grup ndërinstitucional pune, i ngritur me urdhrin nr. 210 datë 10.11.2025, të Kryeministrit, me qëllim hartimin e projektakteve nënligjore që burojnë nga ligji nr. 43/2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt””.

Mbledhjet e Grupit ndërinstitucional të punës u drejtuan nga Ministria e Punëve të Brendshme, nën drejtimin e Zëvendësministres së Punëve të Brendshme. Grupi i punës përbëhej nga 14 anëtarë, përfaqësues të institucioneve kryesore, përgjegjëse në fushën e migracionit, vizave, punësimit, sigurisë dhe shërbimeve elektronike, nga Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, konkretisht nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore, si dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përmes strukturave përgjegjëse për politikën e punësimit dhe migratore.

Në total janë zhvilluar 7 (shtatë) mbledhje të Grupit ndërinstitucional të punës, të cilat janë mbështetur nga sekretariati teknik për migracionin (sektori i migracionit), në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Projektvendimi, së bashku me dokumentacionin shoqërues u konsultua nëpërmjet publikimit në RENJKP, prej datës 4.2.2026 deri në datë 4.3.2026, duke marrë 646 shikime dhe 0 komente.

Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan

palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metoda e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””, ishte:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

3.Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nuk ka patur grupe interesi që kanë dhënë komente/kanë kontribuar në procesin e konsultimit publik.

4. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	(Pranuar/Pranuar pjesërisht/Refuzuar)	